

E

18.5H-1

L 19

IROKASTËR

SHTETI

NATASHA
LAKO

**Yllësia
e fjalëve**

poezi

SH-1
LIP

Natasha
Lako



49212



**Yllësia
e fjalëve**

poezi

SHTËPIA BOTUESE
«NAIM FRASHËRI»

YLLËSIA E FJALËVE

Shokëve poetë

Eja, eja sa më parë
dhe ti me mua dhe ti me ne,
se e pafundme është fjala,
si të pafundme janë qiejt.

E zër një fjalë ti të zjarrtë
si yll të vogël atje lart,
e gjej shoqen më të artë
e lidhi bashkë në një varg.

O fjalë e vogël miturake,
që më ndriçon me aq shkëlqim,
ti më e largët mos qëndro,
në shoqet dil!

Edhe çdo varg
edhe çdo vjershë
që lind si dritë në pafundësi
konstelacion le të jetë,
një yllësi.

(Arushë e Madhe, Arushë e Vogël,
Rrugën e Qumështit njësoj
poetët derdhën pa fund në fletë
ku shqipja jonë fluturoi.)

Dhe ç'forcë mban fjalët me njëra-tjetrën,
si yllësia yjet mban, —
është dashuria më e shtrenjtë,
fuqi e emrit shqipëtar.

PËRPARA SHTËPISË SË LIDHJES
SHQIPTARE TË PRIZRENIT

A të kujtohet?

Ne prisnim të hapej shtëpia e madhe
e mbanim mbi supe

qiellin si shall. K

A të kujtohet,

mbi supe po zbrisnin retë nga mali
dhe ne shpejtuam të nxirrnim aparatën.

A të kujtohet,

një fotografi bëmë

e dolëm të mjegullt nga mjegulla e rënë.

E prisnim jashtë

sikur shtëpia diçka do të na thoshte,

e hodhëm duart mbi statujat

e bronza.

E brenda ishin ata që njëqind vjet më parë
Shqipërisë së shtrenjtë besën i dhanë.

Ata që nuk kishin në çastet vendimtare
as aparate as blica gazetari.

Ata që arritën të lidhin me një fjalë
dhjetëra lumenj të rrëmbyeshëm
e dhjetëra vargmale.

Ata që fiksuan në një kohë plot mjegull
një Shqipëri të veshur me shekuj.

...E pritëm edhe më, edhe dy tre sekonda
e hodhëm duart mbi statujat e bronza.

MONUMENTI I LUFTËTARIT TË LIRISË

Pranë teje unë hodha hapat e parë,
o njeri prej guri... > Toki conse
Më shumë se gjithkund
mund të mësosh ecjen
pranë trupit tënd të palëvizshëm,
o njeri prej guri.
Dhe gjithë jetën do të ec,
drejt vështrimit tënd,
o njeri prej guri.

QËNDISJA E FYTYRËS SË AVNI
RËSTEMIT NGA VAJZAT E LIBOHOVËS

Qelbesim / amicitia / zotësi
Lëvizin duart e vajzës pafundësisht,
si pëllumba të bardhë mbi gjergjef,
dhe zgjojnë ngadalë-ngadalë fytyrën e tij
dhe buzëqeshjen.

preskripte
E futin pastaj në valixhen e vogël,
e vënë, kur ikin, në taksi.

«Na, moj shpirt i nënës,
e more me vete Avninë?» *pyetje retorike*

Dhe duart e nuses
në fund të dasmës,
si në vend të riteve të tjera të

zgjojnë përsëri

fytyrën e tij

dhe buzëqeshjen.

KOCI BAKO X

Morava kishte humbur mes qiellit
të murrmë,
që më i lartë të ishe ti në relief,
Koci Bako.

E ti re,
që më i lartë se ti
të ishte flamuri i kuq.

E atë ditë të shtrenjtë
8 Nëntori
rrëkeza jote e gjakut
kulloi në themelet e Partisë.

Ishte flija më e bukur,
Koci Bako,
që i bëhej Shqipërisë.

VILHELM TEL

Nëpër muret e kohës
në afishe na del
përmbi diell e llohë

«Vilhelm Tel»,
«Vilhelm Tel». *Onofori*

Ca vajza të vogla
mbi ca shkronja shqip
Vilhelm Telin e hipën
më 1900.

Dhe një mollë të kuqe
çuan në shkollë,
por shkollën e mbyllën
dhe mollën ua hodhën.

Edhe molla e kuqe
rrokullis, rrokullis,
nëpër tokën shqiptare
veshi petkun e zisë.